

**1st Call for Proposals under IPA III published!**

**The deadline for submitting concept notes is October 25, 2024**

**Cross-Border Cooperation**

Montenegro – Kosovo

Funded by the European Union

# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

i programeve IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë 2014-2020 dhe 2021-2027

## Shtator 2024

PËRMBAJTJA

Edicioni i njëzetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë\* 2014-2020 dhe 2021-2027. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian. Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

### Programi IPA III BNK Mal i Zi - Shqipëri

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial duke përmirësuar cilësinë e jetës së popullsisë në zonën ndërkufitare të programit nëpërmjet zhvillimit të turizmit bazuar në trashëgiminë kulturore/natyrore dhe duke mbrojtur mjedisin.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA III BNK Mal i Zi- Kosovë

2021-2027

Qellimi i përgjithshëm i programit është të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në Bashkimin dhe të kontribuojë në zhvillimin social, ekonomik dhe territorial të zonës ndërkufitare të programit duke përmirësuar punësimin, lëvizshmërinë e punës dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përtej kufijve; dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- Publikohet Thirrja e Parë për projekt propozime në kuadër të IPA III!.....2
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri .....2
- Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....4
- Promovohet Programi IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri.....9
- Mbahet në Podgoricë mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit..... 9
- Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët potencialë në kuadër të IPA III Mali i Zi – Kosovë.....10
- Forumi i Kërkimit të Partnerëve për Thirrjen e parë për propozime në kuadër të IPA III Mali i Zi – Kosovë.....10

**Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbytja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri dhe Mali i Zi-Kosovë dhe nuk paraqet domosdoshmërisht mendimet e Bashkimit Evropian.**

\* Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

# CBC ZOOM

## Publikohet Thirrja e Parë për projekt propozime në kuadër të IPA III!!!

Thirrja e parë për projekt propozime në kuadër të Programit IPA III CBC Mali i Zi-Kosovë 2021-2027 u publikua më 10 shtator 2024. Afati i fundit për dorëzimin e koncept notave është **25 tetori i vitit 2024**.

Thirrja është e hapur për pushtet lokale të përfaqësuar në zonën e programit, organizatat/agjencitë e zhvillimit lokal dhe rajonal, autoritetet kombëtare dhe institucionet që mbikëqyrin turizmin, mjedisin, politikat kulturore, shoqatat e biznesit, organizatat mbështetëse të biznesit, institucionet e promovimit të vetëpunësimit, dhomat e tregtisë dhe artizanatit, organizatat e shoqërisë civile, kooperativat/shoqatat e fermerëve, organizatat/agjencitë e zhvillimit, institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore, organizatat dhe institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale.

Në kuadër të kësaj thirrjeje do të mbështeten projekte me vlerë deri në **400 mijë euro** që synojnë rritjen e punësimit ndërkufitar të rinjve dhe grupeve vulnerabël, si dhe projekte me vlerë deri në **600 mijë euro** që synojnë nxitjen e turizmit të qëndrueshëm në rajonin ndërkufitar. Kohëzgjatja e projekteve është e kufizuar në **26 muaj** për projektet në fushën e punësimit dhe **30 muaj** për projektet në fushën e turizmit, ndërsa buxheti i përgjithshëm i kësaj thirrjeje është **5.4 milionë euro**.

Zona e programit në Mal të Zi përfshin komunat: Andrijeviçë, Tivar, Berane, Bijello Pole, Guci, Kolashin, Mojkovac, Petnjicë, Plavë, Podgoricë, Rozhajë, Tuz, Ulqin dhe Zetë. Në Kosovë zona e programit përfshin komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik, Deçan dhe Gjakovë.

Të gjitha informacionet në lidhje me Thirrjen e Parë gjenden në këtë [link](#).

## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### Mbështetje për sipërmarrësit potencial në zonën e Fushë-Arrëzit dhe Malësisë së Madhe

Në muajin gusht të vitit 2024 u publikua Thirrja për Shprehje Interesi për mbështetje ndaj sipërmarrësve potencialë në zonën e Fushë-Arrëzit dhe Malësisë së Madhe. Thirrja përfshin një proces përzgjedhjeje me dy hapa, pra do të bëhet parapërzgjedhja e 10 kandidatëve, pas së cilës do të bëhet përzgjedhja përfundimtare me një maksimum prej 5 kandidatësh, të cilëve do t'u jepen maksimum 5000 euro për të investuar në bizneset e tyre të reja.

Përparësi do t'u jepet bizneseve fillestare që përfshijnë grupe vulnerabël, aktivitetet që punësojnë grupe vulnerabël, nismave të biznesit që promovojnë lëvizshmërinë ndërkufitare të krahut të punës, krijimit të produkteve dhe shërbimeve të reja, zhvillimi i planit të marketingut,

strategji të rrjetëzimit, krijimi i strukturave operacionale dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për grupet vulnerabël (gratë, të rinjtë,



personat e papunë afatgjatë, personat me aftësi të kufizuara). Idetë e propozuara duhet të zhvillohen në Bashkitë Fushë-Arrëz dhe/ose Malësi e Madhe, mundësisht t'i përkasin një ose më shumë sektorëve të ndërhyrjes si: Mbrojtja e Mjedisit, Menaxhimi i Mbetjeve, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural (Ekonomia e Gjellbër), Turizmi, Teknologjia dhe Inovacioni.



Gjatë korrikut të vitit 2024, Instituti për Politika të Qëndrueshme në bashkëpunim me Bashkinë Fushë-Arrëz organizoi 5 trajnime teorike, gjatë të cilave 35 aplikantë të përzgjedhur nga të papunët afatgjatë nga zonat rurale dhe periferike të Fushë-Arrëzit dhe Malësisë së Madhe morën pjesë në këto aktivitete për ngritjen e kapaciteteve që përfshinin një sërë temash të tilla si metodat e kërkimit të punës, rregullat për t'u paraqitur në një intervistë pune, kompetencat për punësim, ndërtimi i markës personale në mediat sociale, rrjetëzimi, komunikimi efektiv në vendin e punës, strategjitë për zgjidhjen e konflikteve, ndërtimi i



marrëdhënieve dhe aftësitë e punës në grup, përdorimi i platformave online, mundësitë e zhvillimit profesional, etj.

### Zhvillohen aksione pastrimi në Guci

Në kuadër të projektit "Aksioni i Përbashkët për Mbrojtjen e Mjedisit – JEPA" të zbatuar nga Komuna e Gucisë dhe Bashkia Pukë, si pjesë e aktiviteteve të projektit, aksionet e pastrimit në Guci përfunduan në korrik të vitit 2024. Përkatësisht, partneri lider me mbështetjen e vullnetarëve pastruan bregun e lumit Gërçar, terrenin sportiv të shkollës, si dhe Burimet e Ali Pashës dhe zonën e Vuthajve. Qëllimi i aksionit ishte të kontribuojë në ruajtjen e mjedisit të Gucisë.



Gjithashtu, për të mbrojtur mjedisin dhe për të përmirësuar komunikimin ndërmjet vetëqeverisjes vendore dhe qytetarëve, partnerët e projektit zhvilluan aplikacionin [Green Alert Gusinje](#) dhe [Green Alert Puke](#), përmes të cilit mundësohet raportimi i një problemi në fushën e mbrojtjes së mjedisit në një mënyrë e thjeshtë dhe në këtë mënyrë të kontribuojë për një mjedis më të shëndetshëm.



### Përzgjidhen për mbështetje idetë më të mira të biznesit

Vazhduan më tej aktivitetet në lidhje me fuqizimin e pjesëmarrësve për të filluar biznesin e tyre në kuadër të projektit "Skills for Jobs" të zbatuar nga Fondacioni Qendra e Start-Up bizneseve Tivar, Dhoma e Ekonomisë e Malit të Zi dhe Agjencia Shqiptare për Zhvillim dhe Investim.



Grupi i aktiviteteve që parashikuan sesione për ngritjen e kapaciteteve, mentorim dhe mbështetje financiare u përfunduan në Mal të Zi dhe në Shqipëri në korrik të vitit 2024. Gjatë seminareve pjesëmarrësit u edukuan mbi mënyrat e mundshme të financimit të ideve të biznesit, si dhe se si të prezantojnë një ide biznesi para financuesve, ndërsa paralelisht ata u mbështetën nga mentorë në zhvillimin e planeve të tyre të biznesit.



Pjesëmarrësit e punëtorive nga të dyja vendet, pas përfundimit të leksioneve dhe me mbështetje mentoruese për fillimin e një biznesi, përgatitën dhe dorëzuan planet e tyre të biznesit. Pas dorëzimit, ata paraqitën idetë e tyre të biznesit në komision. Çmimet fituese në vlerë prej 3.000 euro u ndanë për 8 planet më të mira të biznesit në Mal të Zi dhe për 5 planet më të mira të biznesit në Shqipëri.

### Pajisje të reja për monitorimin e pyjeve në Tivar dhe Shkodër

Monitorimi më i mirë i pyjeve, biodiversitetit dhe shëndetit të ekosistemit është bërë i mundur nga teknologjitë e sensorit në distancë, imazhet satelitore dhe Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) që po përdoren në Bashkinë Shkodër dhe komunën e Tivarit, duke kontribuar ndjeshëm në përmirësimin e ruajtjes dhe menaxhimit të pyjeve.



Sistemi i Zbulimit të Zjarrit është dorëzuar në Shkodër dhe Tivar gjatë korrikut të vitit 2024, ndërsa projekti do të mundësojë më tej ndërtimin e një stacioni monitorimi të pajisur me mjete të avancuara të përpunimit dhe vizualizimit të të dhënave në Volujica në Tivar dhe në kodrën e fshatit Bardhaj në Njësinë Administrative Rrethina.

Projekti "Ndërtojmë Pyje të Zgjvara" synon zbulimin e hershëm, minimizimin e zjarrit, mbrojtjen e jetëve njerëzore dhe përmirësimin e efikasitetit në menaxhimin e zjarrit, dhe po zbatohet nga Fondacioni për Autonomi dhe Qeverisje Vendore (FLAG) nga Shqipëria, në partneritet me komunën e Tivarit dhe bashkinë e Shkodrës.

Co-funded by  
the European Union

MNE-ALB  
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Kontakte emergjence në Shqipëri  
☎128 Shërbimi Zjarrfikës  
☎112 Shërbimi i Emergjencës  
☎129 Policia e Shtetit

Kontakte emergjence në Mal të Zi  
☎123 Shërbimi Zjarrfikës  
☎112 Shërbimi i Emergjencës  
☎122 Policia e Shtetit



FLAG  
FOUNDATION FOR LOCAL AUTONOMY AND GOVERNANCE

BUILDING  
SMART  
FORESTS



### Mbahen seminare kombëtare

Dy seminare kombëtare u organizuan në kuadër të projektit "Pellgu Ujëmbledhës i Liqenit të Shkodrës –Një Rezervatit Ndërkufitar i Biosferës" që po zbatohet nga qendra EDEN, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri dhe EnvPro dhe Parqet Kombëtare në Mal të Zi.



Konkretisht, në vazhdim, seminari i dytë kombëtar u mbajt në periudhën 12 – 14 qershor të vitit 2024 me fokus analizën e situatës, modelin konceptual dhe zonimin në lidhje me përpjekjet për përgatitjen e Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës për emërimin e tij si Rezervat

Ndërkufitar të Biosferës. Gjithashtu, seminari i tretë kombëtar për krijimin e Rezervatit Ndërkufitar të Biosferës së Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës u mbajt në Mal të Zi duke u fokusuar në të kuptuarit e funksioneve rezervateve MAB të UNESCO-s dhe identifikimin e kërcënimeve prioritare, trajtimin e sfidave të përbashkëta dhe përafrimin e strategjive për mandatin e ardhshëm të rezervës së biosferës, si dhe në zhvillimin e strategjive të komunikimit dhe edukimit për rezervatin e ardhshme.



### Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e III-të të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

#### "VEPRO MENÇUR - KURSE UJIN"

Projekti "VEPRO MENÇUR - KURSE UJIN" implementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim në bashkëpunim me Sh.PK Ujësjellës "Vodovod Bistrica" nga Bijello Pole dhe Ujësjellësin Rajonal "Hidrodrini" – Sh.A. Pejë, vazhdoi me aktivitetet e tij me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të ujërave në komunat e Pejës dhe Bjello Polës.

Partnerët e projektit janë duke përfunduar aktivitetet që parashikojnë prokurimin, shpërndarjen dhe instalimin e sistemit inteligjent të ujëmatësve në zonën e përzgjedhur në komunat ndërkufitare. Qëllimi i këtij aktiviteti është zvogëlimi i humbjeve të ujit duke zëvendësuar dhe instaluar ujëmatës për lexim në distancë. Pajisjet tashmë janë dorëzuar në KRU "HIDRODRINI" – Pejë dhe së shpejti do të dorëzohen në "Vodovod Bistrica" në Bijello Pole.

#### Tuzi dhe Peja së bashku për qytete më të pastra dhe të gjelbëruara

Komuna e Tuzit dhe Komuna e Pejës vazhdojnë me zbatimin e projektit "Qasja e re e Revitalizimit të Mjedisit – NERA".


Dëgjimi Publik i Planit Lokal të Veprimit për Mjedisin u organizua në Pejë dhe qytetarë me profesione të ndryshme u mbledhën për të ndarë njohuritë dhe sygjerimet e tyre përpara miratimit përfundimtar të



dokumentit. Rrjedhimisht, pas konsultimeve publike, Kuvendi Lokal i Komunës së Pejës miratoi zyrtarisht Planin Lokal të Veprimit për Mjedisin më 29 maj të vitit 2024. Ky plan shënon një hap të rëndësishëm drejt një të ardhmeje më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për të dy komunitetet.



Për më tepër, në kuadër të projektit aplikacionet [Nera - T](#) dhe [Nera - P](#) u krijuan dhe lansuan për të rritur efikasitetin e shërbimeve komunale në menaxhimin e mbeturinave dhe për të nxitur komunikimin më të mirë me qytetarët për të përmirësuar mbrojtjen e mjedisit.



Për të rritur ndërgjegjësimin për menaxhimin e mbeturinave, partnerët e projektit organizuan dy sesione edukative me prodhues bujqësorë nga Tuzi dhe Peja, duke u fokusuar në parimet kryesore të kompostimit dhe metodat për efikasitet të cilësisë, si dhe praktikat më të mira në Evropë të ndërmarra nga kompanitë më të suksesshme në zbatimin e konceptit "Zero mbetje". Gjithashtu, janë mbajtur 20 sesione edukative me mbi 700 nxënës të shkollave të mesme në Pejë dhe Tuz, të fokusuar kryesisht në reduktimin e mbeturinave, ripërdorimin, riciklimin dhe kompostimin, si elemente kyçe të menaxhimit të duhur të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis.



Komuna e Pejës ka blerë fshesa elektrike të rrugëve, makina të teknologjisë së lartë që do të mundësojnë një mënyrë më të lehtë dhe më efektive për mirëmbajtjen e rrugëve, si dhe mjete mirëmbajtjeje si prerëse vetëlëvizëse të barit dhe prerëse të gardheve, duke siguruar që zonat e gjelbra të mirëmbahen lehtë.



Përveç kësaj, për të përmirësuar menaxhimin efikas të mbeturinave dhe riciklimin në komunitet, komuna e Tuzit vendosi kontejnerë nëntokësor për ndarjen e mbeturinave në të gjithë komunën, si dhe kosha plastike me kapacitet të madhë në 10 lokacione kyçe për katër lloje mbetjesh: plastike, letër, metal dhe mbetje organike. Në anën tjetër, komuna e Pejës vendosi shporta për deponimin e mbeturinave të vogla përgjatë lumit në Pejë.





Po ashtu, punëtorët e "Komunalno – Komunale" SH.PK në Tuz përfunduan aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve në bazë të konceptit "Zero mbetje" dhe nisën aktivitetin e shpërndarjes së thasëve për ndarjen e mbeturinave për 480 amvisëri. Ndiqni [faqen e projektit](#) për më shumë informacion.

## Përgatitja e të rinjve për punësim

Partnerët e projektit Instituti për Studime dhe Prognoza Strategjike (ISSP), Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Oda Ekonomike e Malit të Zi dhe Komuna e Mojkovcit në kuadër të projektit *NEET të rinj: mundësi të reja për punë dhe rritje të punësimit* – "UNEETED" kanë filluar me aktivitete që synojnë të përmirësojnë pozitën sociale të NEET-ve të rinj në 8 komuna në Mal të Zi dhe Kosovë.

Trajnimi për *NEET* të rinj në Bijello Pole u mbajt në periudhën 12 – 14 qershor të vitit 2024, i cili mbledhi së bashku 20 të rinj nga Bijello Pole dhe Kosova. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën mundësinë të shprehin problemet dhe sfidat e tyre në integrimin në shoqëri, kërkimin e punës, qasjen në arsim dhe zhvillim profesional. Diskutimet u fokusuan në aspekte të ndryshme të tregut të punës, tendencat aktuale dhe mënyrat se si të rinjtë të përgatiten më mirë për punësim.



Gjithashtu, INDEP organizoi një seminar të përbashkët me 20 të rinj NEET nga Kosova dhe Mali i Zi, në Pejë në periudhën 5 – 7 korrik të vitit 2024. Gjatë tri ditëve, pjesëmarrësit u angazhuan në ligjërata që mbulonin mundësitë e punësimit, aftësitë thelbësore dhe trendet aktuale të industrisë. Seminari ofroi një platformë të vlefshme për këta individë të rinj që të rrisin punësueshmërinë e tyre, të njohin më mirë çështjet, të socializohen dhe të përgatiten për mundësitë e ardhshme të karrierës. Partnerët e projektit gjithashtu finalizuan dhe publikuan kërkimet që synojnë të identifikojnë sfidat me të cilat përballen të rinjtë NEET dhe të eksplorojnë mundësi të reja për përmirësimin e punësimit dhe integrimin e tyre në fuqinë punëtore të [Malit të Zi](#) dhe [Kosovës](#).

## Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të rinjtë në Kosovë dhe Mal të Zi

Në kuadër të projektit "Pa Kufi!" zbatuar nga Oda Ekonomike e Malit të Zi, Oda Ekonomike e Republikës së Kosovës, Qendra Rajonale e Biznesit Berane dhe Instituti i Arsimit, Trajnimeve dhe Kërkimeve (ETRI), u hap gjatë korrikut të vitit 2024 thirrja për shprehjen interesimit për ndjekjen e trajnimeve të certifikuara për guida turistike në Kosovë.

Që nga maji i vitit 2024, partnerët në Kosovë kanë organizuar trajnime për 15 të rinj nga komunat e Pejës, Istogut, Klinës, Junikut, Deçanit dhe Gjakovës. Të rinjtë në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë me mentorimin nga ekipi i ekspertëve të angazhuar në projekt. Pas trajnimit, të rinjtë e certifikuar do të kenë mundësinë të aplikojnë për grante financiare për të filluar me zbatimin e ideve të biznesit.



Në Mal të Zi u përfundua me sukses trajnimi tre mujor për zhvillimin e ideve të biznesit, gjatë të cilit pjesëmarrësit patën mundësinë të fitojnë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përmirësuar idetë e tyre të biznesit. Trajnimi përfshinte përcaktimin e problemit, analizën e grupit të synuar, gjenerimin dhe zhvillimin e ideve të biznesit, si dhe testimin dhe prototipin e ideve, rëndësinë e planifikimit strategjik për zhvillimin e biznesit, analizën e mjedisit dhe nevojave (analiza SWOT, PESTEL) dhe rëndësinë e përcaktimit të qëllimeve të biznesit dhe zgjedhjes së strategjive për arritjen e qëllimeve. Të pranishmit u njohën me modele të ndryshme të regjistrimit të kompanive, kushtet ligjore-administrative, lejet dhe licencat e nevojshme për fillimin e një biznesi. Pjesa praktike e trajnimit përfshinte përgatitjen e një liste kontrolli të dokumenteve të nevojshme për regjistrimin e biznesit.



Për më tepër, përmes trajnimeve mbi marketingun dixhital dhe të përbajtjes, pjesëmarrësit u njohën me elementët kyç të marketingut dixhital si faqet e internetit, rrjetet sociale, e-mail, SEO dhe PPC. Nëpërmjet ushtrimeve praktike, ata patën mundësinë të krijojnë profile në rrjetet sociale dhe të zhvillojnë strategji të përbajtjes, duke u fokusuar në integrimin e kanaleve të ndryshme të marketingut dixhital.

## Pajisje dhe automjete për kompanitë komunale në Mal të Zi dhe Kosovë

Përmes projektit "Marrëveshja e gjelbër ndërkufitare", partnerët e projektit, FORS Mali i Zi, ECMI Kosova dhe Komuna e Beranës, vazhdojnë me aktivitetet që synojnë përmirësimin e mbrojtjes së



mjedisit në rajonin ndërkuftar ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës. Në Mal të Zi ka përfunduar prokurimi i automjeteve për ndërmarrjet komunale dhe inspektimet dhe 2 vetura si dhe një kamion për grumbullimin e mbeturinave janë dorëzuar në institucionet përkatëse, ndërsa pajisjet për ndërmarrjet komunale dhe inspektimet në Kosovë do të prokurohen në periudhën e ardhshme.



Trajnimi i dytë ndërkuftar për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta u organizua në Pejë në maj të vitit 2024 për përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, shërbimet komunale dhe inspektuese dhe kompanitë komunale me qëllim të forcimit të kapaciteteve të tyre dhe zhvillimit të bashkëpunimit ndërkuftar në këtë fushë. Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen me mundësitë e përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve përmes njohjes me standardet dhe praktikatat moderne në këtë fushë, rëndësinë e ekonomisë rrethore në menaxhimin e mbetjeve, projektimin dhe planifikimin e zonave hapsinore, masat për rehabilitimin e tyre etj. Në këtë drejtim, partnerët e projektit publikuan broshurën mbi praktikatat e mira të Bashkimit Evropian në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, e cila mund të shkarkohet [këtu](#).



Disa ECO ngjarje dhe aktivitete u zhvilluan nga partnerët e projektit të dy anët e kufirit. Përkatësisht, partnerët shënuan Ditën e Tokës dhe Ditën Botërore të Mjedisit, ndërsa ECO karavanet me aktivitete promovuese inicuan në Klinë më 5 qershor të vitit 2024.



Për më tepër, u organizuan 26 ECO punëtori për mbi 500 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe 5 ECO punëtori për mbi 150 persona nga komunitetet lokale. Gjithashtu, fushata ndërgjegjësuere për reduktimin e përdorimit të qeseve plastike është duke vazhduar përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me qytetarët dhe në bashkëpunim me bizneset lokale. Hulumtimi mbi strukturën e mbeturinave në disa nga komunat e synuara dhe mundësitë për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave është duke vazhduar në Mal të Zi dhe në Kosovë.

## Shfrytëzimi turistik i Kalasë Tumbaricë dhe Hamamit turk në Pejë është në process

Partneri kryesor Muzeu i Polimljes nga Berane dhe OJQ-ja "Marimangat e Pejës" nga Kosova vazhduan me punimet konservuese në lokacionin arkeologjik Tumbarice dhe në banjën turke në Pejë në kuadër të projektit "Evokimi dhe tërheqja e trashëgimisë kulturore – Antikiteti i Krishterë dhe Banja Turke për Turizëm Kulturor".



Në kuadër të projektit, në Berane u organizua manifestimi arkeologjik për rini në periudhën 5-6 qershor të vitit 2024, me qëllim informimin dhe rritjen e njohurive të studentëve për metodat dhe teknikat që përdoren gjatë punimeve të gërmimit dhe konservimit, si dhe për skanimin 3D dhe fotogrametri si metoda bashkëkohore për ruajtjen dhe monitorimin dixhital të objekteve dhe monumenteve kulturore.



Veprimtaria përfshinte ligjerata arkeologjike dhe punëtori me studentë, ndërsa studentët nga Berane dhe Peja kaluan një kohë të mrekullueshme



duke eksploruar kështjellën historike të Tumbarices. Për më tepër, partnerët e projektit krijuan platformën dixhitale për modelet 3D me informacione të Antikitetit Krishterë dhe Banjes Turke që krijojnë materiale tërheqëse kulturore dhe turistike dhe informacion lehtësisht të aksesueshëm për turistët, vizitorët dhe studiuesit. Ju lutemi shikoni videon e modelit të platformës dixhitale [këtu](#).

### C.L.O.S.E.R.

Në Kosovë, një aktivitet i ri dhe inovativ lindi nga punëtoritë për zhvillimin e Planit të Menaxhimit për Creative Hub West. Kjo iniciativë është vendosur të testojë ndikimin rajonal të aktiviteteve të projektit në pjesën perëndimore të Kosovës. Përkatesisht, punëtorja mblodhi studentë nga gjashtë komuna të Rajonit Ekonomik Perëndimor për një eksperiencë të paharrueshme në objektin e trashëgimisë kulturore "Ura e Fshejt". Ky aktivitet pilot emocionues synonte të nxiste bashkëpunimin rajonal dhe vlerësimin kulturor për aventurën mes të rinjve. Duke integruar trashëgiminë kulturore me aktivitetet në natyrë, partnerët e projektit synuan të krijojnë një përvojë të paharrueshme që nxjerr në pah përzierjen unike të historisë dhe natyrës në rajonin e synuar.



Gjithashtu, partnerët e projektit paralajmëruan përfundimin me sukses të dy aktiviteteve kryesore në Komunën e Tivarit. Konkretisht, dy punëtorë pasurues me fokus "Përmbajtjen e interpretimit të rrugëve të rigjallëruara kulturore të Qytetit të Vjetërtë Tivarit" u organizuan dhe mblodhën ekspertë dhe entuziastë nga të dy anët e kufirit për të thelluar në historinë, kulturën dhe të ardhmen e këtij vendi ikonik të trashëgimisë. Gjithashtu, u organizua një kurs trajnimi ndërkuftar i avancuar që synonte fuqizimin e të rinjve vendas me aftësi thelbësore STEM. Duke u fokusuar në modelimin dhe programimin 3D, kjo nismë është vendosur të krijojë revolucion në menaxhimin e turizmit duke nxitur inovacionin dhe aftësitë teknike midis pjesëmarrësve të rinj të talentuar.



Fondacioni i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë pa Kufij dhe Komuna e Tivarit janë duke zbatuar projektin "C.L.O.S.E.R. – Mundësi të udhëhequra nga kultura për rivitalizim të qëndrueshëm ekonomik".

### Trajnime në punë për të rinjtë

OJQ Juventas nga Mali i Zi dhe OJQ Labyrinth nga Kosova në kuadër të projektit "Në Punësim, Edukim, Trajnim - IN EET" vazhduan me aktivitete të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve për të kontribuar në punësueshmërinë dhe mundësitë për përfshirjen sociale të grupeve të cenushme të popullsisë dhe për qasjen e tyre në tregun e punës. Në këtë drejtim, për të rinjtë u mundësuan trajnime në punë, praktika, trajnime të specializuara dhe të certifikuara dhe praktika pune.

Përkatesisht, për të rinjtë në Mal të Zi janë ofruar 40 trajnime në punë, prej të cilave 28 janë përfunduar dhe 12 janë në përfundim.

Rrjedhimisht, deri më tani kanë mbetur të punësuar 12 persona trajnimin në vendin e punës. Gjithashtu, kurset e rikalifikimit janë modifikuar sipas nevojave të grupit të synuar dhe deri më tani janë siguruar 10, ndërsa 10 do të organizohen për grupet e tjera të të rinjve. Për më tepër, në burg janë ofruar 18 kurse profesionale në Mal të Zi. Në Kosovë, deri më tani janë duke vazhduar 22 trajnime në punë për të rinjtë dhe janë planifikuar edhe 18 të tjera, ndërsa për të burgosurit janë duke u ofruar 15 kurse profesionale. Gjithashtu, janë planifikuar që të ofrohen kurse rikalifikuese edhe në Kosovë.



që kanë përfunduar trajnimin në vendin e punës. Gjithashtu, kurset e rikalifikimit janë modifikuar sipas nevojave të grupit të synuar dhe deri më tani janë siguruar 10, ndërsa 10 do të organizohen për grupet e tjera të të rinjve. Për më tepër, në burg janë ofruar 18 kurse profesionale në Mal të Zi. Në Kosovë, deri më tani janë duke vazhduar 22 trajnime në punë për të rinjtë dhe janë planifikuar edhe 18 të tjera, ndërsa për të burgosurit janë duke u ofruar 15 kurse profesionale. Gjithashtu, janë planifikuar që të ofrohen kurse rikalifikuese edhe në Kosovë.

### Festalet e turizmit në natyrë në Mal të Zi dhe Kosovë

Në kuadër të projektit "Turizmi për të Ardhmen", partnerët OJQ REA Prishtinë dhe Shoqata Alpinistike "Gjeravica", Komuna e Kollashinit dhe Instituti për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekonomik organizuan evente promovuese që kishin për qëllim promovimin dhe brendimin e sektorit të turizmit në Kollashin dhe Pejë. Përkatesisht, janë organizuar festalet turistike dhe janë krijuar eko-shtigje në këto dy qytete, të cilat kanë mundësuar ndërkombëtarizimin e ofertës turistike, trashëgimisë dhe kulturës.





**Festivali i turizmit në Pejë** u organizua në periudhën 24 – 26 maj të vitit 2024 dhe kishte për qëllim të shërbejë si dëshmi e përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve publike dhe private në avancimin e sektorëve të turizmit dhe trashëgimisë kulturore në Pejë. Nëpërmjet një game të gjerë aktiviteteve dhe eventesh, vizitorët patën mundësinë të eksplorojnë bukurinë natyrore, aventurën dhe trashëgiminë kulturore të zonës. Aktivitetet përfshinin shëtitje, çiklizëm, ngjitje shkëmbinjsh, paragjajding dhe shumë të tjera, duke përfshirë udhëtime në shtigjet kulturore të Pejës. Përveç aventurës dhe trashëgimisë, festivali ofroi edhe programe dhe konferenca të pasura kulturore që trajtojnë çështje të rëndësishme si zhvillimi i infrastrukturës së turizmit të aventurës dhe sfidat në menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm. Ju lutemi shikoni videon nga ngjarja nga Peja [këtu](#).



**Festivali i Turizmit "Kolashin Open Fest"** u organizua në periudhën 28–30 qershor të vitit 2024. Koncepti i festivalit u krijua për të bashkuar dhe ndërthurur aspektet e natyrës, aventurës, kulturës dhe turizmit të qëndrueshëm. Partnerët e projektit shprehajn ta bëjnë këtë festival si një ngjarje tradicionale që do të tërheqë vizitorë nga e gjithë bota për shumë vite me rallë. Qëllimi i festivalit ishte ndërtimi i një identiteti turistik duke ofruar gëzim dhe argëtim, shije dhe aventura, promovim dhe rrjetëzim të potencialeve turistike, mundësive dhe lidhjeve të Kollashinit me rreth 30 aktivitete dhe evente të ndryshme të organizuara gjatë tre ditëve të festivalit.



Aktivitetet fillestare parashikuan një udhëtim panoramik safari me xhip, të ndjekur nga aktivitete të tilla si shëtitje, çiklizëm, ngjitje në shkëmb, ecje përgjatë shtegut edukativ, me shëtitje opsionale me varkë, nëpërmjet ferratës në fshatin Lipovë, turne, degustim i ushqimeve tradicionale, kënde edukative për fëmijë, rafting, vrapim, zip line, park aventure, pikturë arti dhe shumë shfaqje muzikore live, etj.

Ju lutemi shikoni videon nga ngjarja në Kolashin [këtu](#).



### **Promovohet Programi IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri**

Në kuadër të Javës së Europës 2024 më 3 maj të vitit 2024, të rinjtë e Gjeneratës së Parë të Shkollës Pranverore Europiane, organizuar nga Bashkia Shkodër me mbështetjen e Bashkimit Europian, patën mundësinë të informohen për arritjet dhe mundësitë e Programt IPA BNK Mali i Zi - Shqipëri.



Nëpunësja e Antenës së Programit në Shkodër, Nersada Mandija, prezantoi rezultatet e projekteve të IPA II, mundësitë në programin e ri IPA III dhe çfarë pritet nga zbatimi për të rinjtë e zonës së programit. Në fund të sesionit, të rinjtë vizituan dhomën muze në Qytetin e Vjetër të Drishtit, e cila është rinovuar me mbështetjen e programit.

### **Mbahet në Podgoricë mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit**

Më 25 qershor të vitit 2024, në Podgoricë, u mbajt mbledhja e Komitetit Drejtues të Projektit për projektin e asistencës teknike. Gjatë takimit u miratua raporti përfundimtar i asistencës teknike të mëparshme dhe u miratua Rregullorja e re e Punës së KDP-së. Më pas, u diskutua për planifikimin dhe kornizen kohore të hapave të ardhshëm në lidhje me Thirrjen e 4-të për Projekt-propozime për Programin Mali i Zi – Shqipëri, si dhe planifikimi dhe përcaktiminkohor të aktiviteteve që lidhen Thirrjen e Parë për Projekt-propozime në kuadër të të dy programet.





### **Aktivite për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët potencialë në kuadër të IPA III Mali i Zi - Kosovë**

Sekretariati i Përbashkët Teknik, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Ministrinë e Financave të Malit të Zi - Drejtoria për Financa, Kontraktim dhe Zbatim të Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, ka organizuar trajnime treditore mbi menaxhimin e ciklit të projektit për aplikantët e mundshëm nga zona e pranueshme e programit ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës.



Në periudhën qershor-korrik të vitit 2024, si pjesë e aktiviteteve përgatitore para publikimit të Thirrjes së parë në kuadër të IPA III Programit BNK Mal i Zi-Kosovë, janë organizuar katër trajnime për hartimin e projekt propozimeve në përputhje me rregullat e BE-së.



Gjegjësisht, dy trajnime për menaxhimin e ciklit të projektit janë dedikuar vetëm për autoritetet lokale dhe janë mbajtur në Tivar në periudhën 11 – 13 qershor për komunat nga Mali i Zi, ndërsa për autoritetet lokale nga Kosova janë mbajtur në Pejë në periudhën 3 – 5 korrik të vitit 2024. Dy trajnimet e tjera iu dedikuan aplikantëve të tjerë potencial nga Mali i Zi dhe Kosova, pra njëri u organizua në Berane në periudhën 19 – 21 qershor dhe njëri në Istog në periudhën 10 – 12 korrik

të vitit 2024. Qëllimi i trajnimeve ishte zhvillimi dhe rritja kapacitetet e autoriteteve lokale dhe aplikantëve të tjerë të mundshëm nga zona e programit nga Mali i Zi dhe Kosova për përgatitjen e projekt propozimeve. Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve ishin krijuar në mënyrë specifike për të përgatitur aplikantët e mundshëm për Thirrjen e ardhshme në kuadër të IPA III Programit dhe u ndoqën nga 59 pjesëmarrës.

### **Forumi i Kërkimit të Partnerëve për Thirrjen e parë për propozime në kuadër të IPA III Mali i Zi - Kosovë**

Forumi i Kërkimit të Partnerëve për projekte u organizua si pjesë e aktivitetit përgatitor para publikimit të Thirrjes së parë në kuadër të IPA III Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë. Forumi u organizua nga Sekretariati i Përbashkët Teknik, në bashkëpunim me Strukturat Menaxhuese të Programit, Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Financave të Malit të Zi – Drejtoria për Financa, Kontraktim dhe Zbatim të Fondeve të Asistencës së BE-së (CFCU). Forumi u organizua në Pejë më 26 korrik të vitit 2024, me qëllim që të ofrojë informacion të detajuar për pjesëmarrësit në lidhje me IPA III Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Kosovë 2021-2027 dhe t'u mundësojë partnerëve të mundshëm të projektit nga të dyja anët e zonës së programit të takohen me njëri-tjetrin, për të ndarë dhe diskutuar idetë e tyre të projektit dhe për të vendosur kontakte personale për formimin e partneritetit të ardhshëm dhe bashkëpunimin e suksesshëm të projektit.



Gjatë sesionit të parë të ngjarjes, pjesëmarrësit u informuan mbi IPA III, parimet e partneritetit ndërkufitar dhe përmbajtjen e përgjithshme të dokumenteve për aplikim. Për më tepër, gjatë sesionit të dytë, pjesëmarrësit morën pjesë në punëtorit tematike me interes të veçantë për ta, ku mësuan më shumë mbi prioritetet tematike të programit, ndanë idetë e projektit, identifikuan partnerë të mundshëm, shkëmbyen detaje kontakti dhe krijuan një bazë për partneritet të mundshëm në të ardhmen me aplikantët në anën tjetër të kufirit.





Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkuar tek web - faqja)



Ministarstvo  
evropskih  
poslova



Montenegro  
Ministry of Finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministristroo Administracjje Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Montenegro  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Nersada MANDIJA**

Zyrtare Projekti, Antenë  
E-mail: [nersada.mandija@saspac.gov.al](mailto:nersada.mandija@saspac.gov.al)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**  
Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,  
Kosovë

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



@cbc.mne.alb



@cbc\_mne\_alb



@cbc.mne.kos



@cbc\_mne\_kos

Cross-Border  
Cooperation



Funded by  
the European Union

Montenegro – Albania

Cross-Border  
Cooperation



Funded by  
the European Union

Montenegro – Kosovo